



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 gusht 2012
Nr. ref.: RK291/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KIo7/11

Parashtruesi

Vebi Klaiqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së moszbatimit të pretenduar të Aktgjykimit të
Gjykatës Komunale në Kamenicë C. nr 79/96, të datës 7 tetor 1997**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Vehbi Klaiqi (parashtrues i kërkesës), me vendbanim në fshatin Korretin, komuna e Kamenicës.
2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin P.Nr.79/96, të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të datës 7 tetor 1997.
3. Parashtruesi i kërkesës pohon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij në punë, për shkak të mungesës së vërtetimit se aktgjykimi i kontestuar është i formës së prerë dhe i detyrueshëm.
4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7, dhe nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 janar 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë.
6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani.
7. Më 11 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Kamenicë për kërkesën.
8. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues, duke zëvendësuar gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj.
9. Më 10 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në NSH "IMKOS" në Kamenicë, si Kryesues i Departamentit të Shërbimeve Ligjore.
11. Më 7 shtator 1990, Drejtori i Ndërmarrjes NSH "IMKOS" në Kamenicë, me vendimin Nr. 544 ka larguar nga puna parashtruesin e kërkesës.
12. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë, për kthimin e tij në marrëdhënie pune dhe për kompensimin e të ardhurave të tij personale prej 1 tetorit 1990.
13. Më 7 tetor 1997, Gjykata Komunale në Kamenicë vendosi (P. Nr. 79/96) të obligojë NSH "IMKOS" që t'i kompensojë parashtruesit të kërkesës për periudhën pas largimit të përkohshëm në shumën prej 78,20 dinarë me kamatë ligjore.
14. Sipas parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë nuk është zbatuar në mungesë të vërtetimit se aktgjykimi është i formës së prerë dhe detyrues, dhe si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka realizuar të drejtën në kompensim.
15. Prandaj, duke filluar nga 15 shkurti 2001, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke kërkuar vazhdimin e procedurës, në mënyrë që të ekzekutohej Aktgjykimi i lartpërmendur.
16. Më 6 maj 2005, Gjykata Komunale në Kamenicë informoi parashtruesin e kërkesës se "Aktgjykimi që ju [parashtruesi i kërkesës] keni kërkuar të bëhet i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, për shkak të mungesës së dosjeve gjyqësore për momentin nuk mund të verifikohet dhe bëhet (...)".
17. Nga shkurti 2001, deri në korrik 2005, parashtruesi i kërkesës, përsëri, me qëllim të ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, nisi procedura të ndryshme para Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Avokatit të Popullit, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
18. Përveç kësaj, më 1 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me përgjigjen e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, parashtroi një kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të ndikuar në Gjykatën Komunale në Kamenicë, në mënyrë që të lëshojë një

vërtetim se aktgjykimi C. Nr. 79/96 i Gjykatës Komunale në Kamenicë, i 7 tetorit 1997 është i formës së prerë dhe detyrues.

19. Duket se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të ekzekutojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është bërë shkelja e së drejtës së tij për kompensimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës, si një e drejtë e garantuar me Kushtetutë, pa iu referuar ndonjë neni të posaçëm të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta obligojë Gjykatën Komunale në Kamenicë që ta lëshojë vërtetimin se aktgjykimi C. Nr. 79/96 është i formës së prerë dhe detyrues.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë (P. Nr. 79/96), të datës 7 tetor 1997, si të plotfuqishëm dhe të detyrueshëm, si kusht për ekzekutimin e tij.
23. Megjithatë, Gjykata Komunale në Kamenicë nuk ishte në gjendje të plotësonte kërkesën e parashtruesit të kërkesës, sepse dosja e rastit nuk ishte e disponueshme, meqë kishte humbur gjatë luftës.
24. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës thekson se “rasti C. nr. 79/96 nuk u gjet në arkivin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, por pothuajse të gjitha dokumentet e rastit janë në arkivin e palës së paditur”.
25. Gjykata analizon nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, specifikuara në Ligj dhe Rregulloren e punës.
26. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari analizon nëse çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, Gjykata duhet të marrë parasysh, edhe faktet për të cilat parashtruesi i kërkesës ankohet dhe fushën e së drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (Shih, Aktvendimin mbi papranueshmëri në rastin Nr. 69/10, Vehbi Halili, të 4 tetorit 2011 dhe gjithashtu *Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin e Blečić v. Croatia, Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82.*).
27. Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) i Ligjit parasheh:
“Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.
28. Në anën tjetër, neni 49 (Afatet) i Ligjit thotë se:
“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.
29. Duke pasur parasysh këto dy dispozita ligjore, duhet konkluduar se juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës Komunale për rastet paraprake fillon nga data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, e që është 15 qershori 2008, dhe përfundon më 15 maj 2009, që do të

thotë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, e që ishte 15 janar 2009.

30. Gjykata vëren se, në këtë rast, Aktgjykimi ishte dorëzuar më 7 tetor 1997 dhe se informata e fundit që kishte dhënë Gjykata Komunale në Kamenicë lidhur me disponueshmërinë e dosjes daton nga 6 maji 2005, që do të thotë, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008. Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 21 janar 2011.
31. Rrjedhimisht, Aktgjykimi ishte dorëzuar para 15 qershorit 2008, data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Gjykata nuk mund ta trajtojë kërkesën që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. (Shih, Aktvendimin e Gjykatës mbi papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, *Denic et al* i 17 gushtit 2011).
32. Për më tepër, rregulli 36 (3h) i Rregullores së punës, parasheh se: „Një kërkesë gjithashtu mund të konsiderohet e papranueshme në rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.“ Prandaj, konsiderohet se kërkesa është *ratione temporis* jashtë juridiksionit të Gjykatës.
33. Kështu që, duhet konkluduar se kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani